



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.330, datë 20.10.2023

PËR

**“FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR  
KANDIDATIN QË KA KANDIDUAR PËR RIEMËRIM NË POZICIONIN E  
DREJTUESIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË  
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, ZOTIT KRESHNIK AJAZI”**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, nenet 159 pika 2 dhe 190 pika 2, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 52 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, nenin 7 të Rregullores “Për miratimin e rregullores mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe pas u njoh me relacionin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

VENDOSI:


1. Të fillojë procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për riemërim në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, zotit Kreshnik Ajazi.
2. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe Njësia e Mbështetjes së Komisioneve për ndjekjen e këtij procesi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 20.10.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaaj

  
**ANËTAR**  
**Sokol Stojani**

  
**ANËTAR**  
**Bujar Sheshi**


  
**ANËTAR**  
**Nurihan Seiti**

  
**ANËTAR**  
**Eloida Goxhi**

  
**ANËTAR**  
**Esmeralda Keshi**

  
**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**

  
**ANËTAR**  
**Mirrela Bogdani**

  
**ANËTAR**  
**Arta Mandro**

  
**ANËTAR**  
**Ledina Riza**